



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.03-0-366
24.11.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3353/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4325/3 datë 23.11.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 38-të mbajtur më 23.11.2023, miratoi si vijon:

Aktvendim
për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkelje të kryer nga neni 51 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor transmetuar më 9 gusht 2023, nuk ka ofruar informacionin që duhet t'i vihen në dispozicion përdoruesve.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3353/1 datë 01.09.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) është kompetente të kryejë mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjit për Media, LSHMAAV dhe dispozitave miratuar në bazë të Ligjit.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 51 paragrafi (1) të LSHMAAV, ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele duhet t'u ofrojnë përdoruesve të tyre qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përshërme për të dhënat në vijim: emrin e ofruesit të shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele, respektivisht titullin, shenjën mbrojtëse ose shenjën e shkurtuar të identifikimit (avizo, logo dhe të ngjajshme); adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audioviziv; të dhënat për kontakt me ofruesin e shërbimit mediatik audio ose audioviziv (numër telefoni, e-mail adresë dhe/ose ueb faqe, personin për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe nëse është e mundëshme dhe të organit rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave të veta ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 1 shtator 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, transmetuar më 9 gusht 2023, në nivel lokal, nga ku konstatoi shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV. Gjegjësisht, nga mbikëqyrja është konstatuar se më 9 gusht 2023, SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, nuk ka ofruar informacionet që duhet t'u vihen në dispozicion

përdoruesve, respektivisht nuk u mundësoi qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme në të paktën për të dhënat në vijim: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatik audio; adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audio; të dhënat për kontakt (numër telefoni, e-mail adresë dhe/ose ueb faqes; personit përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për organin rregullator kompetent.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3353/1 datë 01.09.2023, e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë më 06.09.2023, ka dërguar Shkresë ark.nr.10-3353/2 datë 06.09.2023, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3353/1 datë 01.09.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 29.09.2023. Në afatin e parashikuar, SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 23.11.2023, e shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë t'i shqiptoi masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3353/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4325/3 datë 23.11.2023, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur 23.11.2023, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmëron SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë dhe obligohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3353/1 datë 01.09.2023.

**Agjencia për shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.